



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 779/2 prot

Datë 14.04.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-16832-12-31-2021, me objekt “*Blerje veshje të plumbuara të stafit që punon me burime të rrezatimit jonizues*”, me fond limit 6,691,851 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.02.2022 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankimues: Operatori ekonomik “Fedos” SHPK
Adresa: Rr. “Manol Konomi”, Nd.14, H.2, Ap.2 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Adresa: “Rruga e Dibrës”, Nr. 372, Tiranë.

Në datën 14.04.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar ankesa me nr. 779 e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-16832-12-31-2021, me objekt “*Blerje veshje të plumbuara të stafit që punon me burime të rrezatimit jonizues*”, me fond limit 6,691,851 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.02.2022 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 779 prot., datë 14.04.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik “Fedos” shpk, nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik pika 2.3 Kapaciteti teknik në DST për sa i përket “Përvojës së suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme”. Ak per përmbushjen e këtij kriteri ka kërkuar: a) Dëshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vleres së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. - Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt. - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Shënim: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, konkretisht mbi vlerat e fondit limit ne piken 2.10. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se vetem njera prej tyre konsiderohet me një zv tw saj me objektin porkurimit, e cila nuk arrin te përmbush vleren e kerkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e vecant te kualifikimit ne masen prej 20% te fondit limit, duke mos plotesuar keshtu kerkesen per kualifikim, per pervoj te suksesshme, pasi kontrata e paraqitur, permbajne objekt dhe zëra të cilet nuk jane te ngjadhëm me objektin e prokurimit Bazuar në ligjin 162/2020 ” Për prokurimin publik”, si dhe vendimin e KPP-së nr.194/2022 prot., datë 23/02/2022, AK vlerëson se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 14.04.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro